



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 477 Prot.

Tiranë, më 5 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 90 , Datë 5 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 26, datë 28.04.2017, të paraqitur nga subjekti ankues L.B, kundër AKSHI¹-t, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues deklaroi se: “Në datë 18.04.2017 është vënë në dijeni për shkresën: “Urdhër Revokimi” nr. 952, datë 28.03.2017 sipas të cilës është revokuar urdhri i emërimit nr. 3329, datë 22.11.2016 për emërimin e L.B në pozicionin e specialistit. L.B pretendon se në datë 28.03.2017 ka qenë me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë sipas raportit nr. 189, datë 31.03.2017² dhe urdhri i revokimit është lëshuar dhe ka hyrë në fuqi në periudhën kur L.B ka qenë e paaftë për punë si pasojë e gjendjes shëndetësore e cila nuk i ka lejuar të vazhdojë normalisht punën”.

L.B informon se, nga vërtetimi i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, rezultoi se nga ana e AKSHI-t nuk i janë dërguar pranë ISSH-s raportet mjekësore të mëparshme për datat 17.12.2016 deri 01.01.2017 dhe 27.01.2017 deri 31.01.2017 si dhe i është dërguar llogaritja jo e saktë e pagës pranë ISSH-s.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e pasojave të ardhura nga diskriminimi.

¹Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

² Raport për paaftësi të përkohshme në punë, për 15 ditë paaftësie që fillon me datë 28.03.2017 deri më 12.04.2017, lëshuar me datë 31.03.2017 nga Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.3, protokolluar nga AKSHI nr.1016, datë 03.04.2017.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, L.B, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr.402/1, datë 03.05.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektivit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga L.B.

Me shkresën Nr. 1439/1, datë 26.05.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në mes të tjerash informon se: *“L.B ka filluar marrëdhëniet e punës me AKSHI-n që prej vitit 2014 si specialiste dhe më pas*

më datë 27.04.2015, është emëruar në pozicionin e Përgjegjës, pranë Sektorit të Përditësimit të Shërbimeve të Portalit, në Drejtorinë e Portalit e-Albania. Me shkresën, Urdhër Emërimi, nr.3329, datë 22.11.2016, L.B është liruar nga detyra e Përgjegjës së Sektorit dhe është emëruar në pozicionin si Specialiste. L.B pasi ka filluar detyrën e re si specialiste, në pjesën më të madhe të kohës nuk është paraqitur në punë duke sjellë një sërë raportesh mjekësorë të cilat AKSHI i ka dërguar pranë ISSH-së. Ndërkohë L.B dhe pse me raporte mjekësore, në keqdashësi, në Janar 2017 ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt dëmshpërblimin për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe rikthim në pozicionin e mëparshëm, pasi propozimi për vijimin e marrëdhënies të punës si Specialiste, për L.B konsiderohej zgjidhje e menjëhershme e marrëdhënies së punës duke qenë se ishte ulje në detyrë. Nga momenti i ngritjes së padisë, dhe pse L.B pretendonte për zgjidhje të marrëdhënies të punës që nga data e Urdhrit të emërimit, 22.11.2016, ka vijuar me raporte mjekësore dhe nga ana e AKSHI-t duke qenë se çështja gjyqësore ishte në proces, i ka konsideruar raportet mjekësore si të paraqitura nga një punëmarrëse duke mos dashur ti shkaktojë dëm nga ana financiare. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 80-2017-930, datë 08.03.2017 ka pranuar pjesërisht padinë, duke konsideruar zgjidhje të marrëdhënies së punës si shkak i ndryshimit të pozicionit të punës pa miratimin e punëmarrësit. Në fund të muajit shkurt 2017, L.B ka paraqitur pranë AKSHI-t raport mjekësor i cili përfundonte më datë 27.03.2017 dhe AKSHI duke respektuar legjislacionin në fuqi, dërgoi raportin mjekësor pranë ISSH. Pas përfundimit të këtij raporti, më datë 28.03.2017, L.B është pritur për t'u paraqitur pranë ambienteve të AKSHI-t, por ajo jo vetëm që nuk është paraqitur në punë por nuk ka patur asnjë njoftim prej saj. Bazuar në Vendimin Nr. 80-2017-930, datë 08.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, AKSHI me shkresën "Urdhër Revokimi" nr.952, datë 28.03.2017, revokoi urdhrin e emërimit nr.3329, datë 22.11.2016 në të cilin i ishte propozuar vijimi i punës si punëmarrëse në pozicionin specialiste, pasi gjykata nuk e konsideroi të vazhdueshëm marrëdhënien e punës si specialiste duke qenë se nuk ishte firmosur kontrata e re e punës dhe ky urdhër emërimi nuk mund të qëndronte. L.B ka paraqitur raport mjekësor pranë AKSHI-t më datë 03.04.2017, protokolluar me nr.Prot 1016, raport i cili ishte lëshuar më datë 31.03.2017, me efekt prapaveprues, ku paaftësia për punë kishte filluar në datën e urdhrer revokimit 28.03.2017. Theksojmë se që nga data 28.03.2017 datë në të cilën duhej të ishte në punë, deri në datë 03.04.2017, nuk ka pasur asnjë njoftim nga L.B për mosparaqitje për arsye shëndetësore apo të çfarë do lloj arsjetimi tjetër. Lidhur me mënyrën dhe procedurën e njoftimit në rast të mosparaqitjes në punë ju bëjmë me dije se L.B e njeh shumë mirë procedurën pasi e ka ndjekur për rastet e tjera të mosparaqitjes në punë. Gjithashtu vlen për të theksuar se nuk ka pasur asnjë diskriminim në trajtimin e L.B, pasi edhe punonjësit e tjerë pranë AKSHI-t kanë ndjekur të njëjtën mënyrë njoftimi në rast të mosparaqitjes në punë (punonjëset R.K dhe E.B). AKSHI lidhur me gjendjen shëndetësore të L.B, thekson se megjithëse ka vijuar për periudhën kohore rreth 6-muaj me paraqitjen e raporteve mjekësore, janë vënë në dijeni se vetë L.B (në të njëjtën kohë që rezulton me raport) është parë në gjendje shumë të mirë shëndetësore në aktivitetet të ndryshme qoftë fizike, biznesi apo si dhe paraqitja e saj në gjykatë".

Lidhur me pretendimin e ngritur nga L.B, se nga ana e AKSHI-t, nuk i janë dërguar pranë ISSH-s raportet mjekësore të mëparshme për datat 17.12.2016 deri 01.01.2017 dhe 27.01.2017 deri 31.01.2017 si dhe i është dërguar llogaritja jo e saktë e pagës pranë ISSH-s, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në mes të tjerash informon se: “L.B ka filluar punë pranë AKSHI-t më 01.03.2014. Gjatë kësaj periudhe deri në Tetor 2016 ka pasur vetëm 12 ditë raport mjekësor dhe për periudhën tjetër në Nëntor 2016 ka paraqitur 6 ditë raport, Dhjetor 2016 ka paraqitur 20 ditë raport, Janar 2017 ka paraqitur 12 ditë raport dhe nga data 27.01.2017 deri më datë 28.03.2017 ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme të pagueshme nga Sigurimet Shoqërore. Sa më sipër sqaruar, L.B ka përfutur sipas legjislacionit në fuqi pagesën për pozicionin e punës, raporte dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka pasur asnjëherë ankesa për pagesat dhe përlllogaritjet lidhur me pagën apo raportet. Me pretendimet e L.B, AKSHI është njohur nëpërmjet shkresës së Komisionerit dhe menjëherë pas këtij njoftimi janë bërë verifikimet e dokumenteve përkatës pranë zyrës së financës nga e cila rezultoi se janë dorëzuar pranë ISSH-së raportet e cituara nga L.B por listëpagesa që i korrespondon periudhës 17.12.2016-01.01.2017 ka një lapsus në përlllogaritjen e saj. Menjëherë pas konstatimit janë ndjekur procedurat përkatëse për sistemimin e pagesës. Nga ana e AKSHI-t nuk ka pasur asnjë diskriminim lidhur me pagesën e raporteve mjekësore apo mënyrës së llogaritjes së saj dhe kjo është e konfirmuar edhe nga ISSH në shkresën nr.3693/1, datë 14.04.2017 nëpërmjet së cilës vërtetohet se nga data 30.01.2017-28.03.2017 L.B është trajtuar me raport mjekësor. Pra është qartësisht e dukshme se është bërë një lapsus në përlllogaritje, pasi jo vetëm nuk mohohet dërgimi i këtij raporti por konfirmohen raportet e tjera të paraqitura pas tij dhe nëse do bëhej fjalë për diskriminim nuk do të ishin dërguar as raportet e tjerë të paraqitura më pas”.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Ankuesja ka filluar punë pranë AKSHI-n në detyrën si specialiste në Sektorin e Standardeve TIK dhe Koordinimit të Projekteve me datë 24.02.2014. Me datë 27.04.2015, është lidhur Kontrata Individuale e Punës mes L.B dhe punëdhënësit AKSHI për kryerjen e detyrave në pozicionin e Përgjegjëses, pranë Sektorit të Përditësimit të Shërbimeve të Portalit, në Drejtorinë e Portalit e-Albania. Me shkresën nr. 3214, datë 09.11.2016 L.B i është komunikuar masa disiplinore “Vërejtje” për shkelje të rregullave të etikës dhe komunikimit në mjediset e brendshme të punës. Dhënien e masës disiplinore L.B e ka kundërshtuar me shkresën datë 14.11.2016 në të cilën është shprehur se nga ana e punëdhënësit nuk i është dhënë mundësia që të parashtrijë pretendimet e saj mbi çdo pretendim të eprorit. Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t me shkesën nr.3214/2, datë 17.11.2016 i është përgjigjur L.B mbi pretendimet e ngritura.

Me shkresën nr. 3328, datë 22.11.2016 L.B i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për shkak të sjelljes dhe mosrealizimit në kohë të detyrave funksionale të cilat ishin bërë pengesë për mbarëvajtjen e punës në ofrimin e shërbimeve elektronike. Po në të njëjtën ditë, me shkresën, Urdhër Emërimi, nr.3329, datë 22.11.2016, L.B është liruar nga detyra e

Përgjegjëses së Sektorit dhe është emëruar në pozicionin si Specialiste. Mes punëdhënësit AKSHI-t dhe punëmarrëses, L.B ka pasur mosmarrëveshje si rezultat i daljes së shkresës së mësipërme “Urdhër Emërimi”, nr.3329, datë 22.11.2016, çështje e cila është gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e cila me Vendimin Nr. 80-2017-930, datë 08.03.2017 ka pranuar pjesërisht padinë, duke e konsideruar, si zgjidhje të marrëdhënies së punës si shkak i ndryshimit të pozicionit të punës pa miratimin e punëmarrësit, dhe ka dëmshpërblyer L.B me nëntë muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pa justifikuar. Pas marrjes së vendimit nga gjykata, AKSHI me shkresën “Urdhër Revokimi” nr.952, datë 28.03.2017, ka revokuar urdhrin e emërimit nr.3329, datë 22.11.2016 në të cilin i ishte propozuar L.B vijimi i punës si punëmarrëse në pozicionin e specialistes.

Me shkresën nr.826, datë 15.03.2017, AKSHI duke mos rënë dakord me vendimin e datës 08.03.2017 ka ankimuar vendimin e mësipërm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Komisioneri vlerëson se shkak që ka rënduar situatën dhe prishjen e marrëdhënieve të punësimit mes AKSHI-t dhe ankueses është bërë dhe fakti që L.B është ankuar tek punëdhënësi duke vënë në dijeni Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe Ministren e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike si në rastin e dhënies së masës disiplinore me vërejtje ashtu dhe kundërshtimi në gjykatë kundër urdhrin të emërimit në pozicionin si specialiste pranë AKSHI-t.

Referuar dokumenteve dhe raporteve mjekësore të depozituara nga palët, rezulton se L.B ka vazhduar marrëdhëniet e punësimit pranë AKSHI-t dhe pas datës 22.11.2017, në pozicionin si specialiste, pavarësisht nga përfitimi i raporteve të paaftësisë të përkohshme në punë nga sëmundje të përgjithshme që paguhen nga Sigurimet Shoqërore ose nga punëdhënësi.

Nga këqyrja e dokumenteve dhe raporteve mjekësore të depozituara nga palët, rezulton se për periudhat prej datave: 14.11.2016 deri 15.11.2016, 18.11.2016 deri 21.11.2016, 25.11.2016, 30.11.2016 deri 02.12.2016, 05.12.2016 deri 09.12.2016, 17.12.2016 deri 01.01.2017, 11.01.2017 deri 13.01.2017, 16.01.2017 deri 26.01.2017, 27.01.2017 deri 26.02.2017, 26.02.2017 deri 27.03.2017, 28.03.2017 deri 11.04.2017, 10.04.2017 deri 24.04.2017, 25.04.2017 deri më 10.05.2017 L.B ka qenë e trajtuar me raport paaftësie të përkohshme në punë nga sëmundje të përgjithshme që paguhen nga Sigurimet Shoqërore ose nga punëdhënësi, pra vërtetohet që L.B dhe përpara se të emërohej në detyrën si specialiste në datë 22.11.2016 dhe pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës në datë 28.03.2017 ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe është pajisur me raporte mjekësore dhe nuk vërtetohet pretendimi i punëdhënësit që: “..L.B pasi ka filluar detyrën si specialiste nuk është paraqitur në punë duke sjellë një sërë raportesh mjekësore³”.

³ Referuar shkresës së AKSHI-t nr.1439/1, datë 26.05.2017.

Nga vlerësimi i dokumenteve të dorëzuara nga palët rezulton se, në fund të muajit Shkurt 2017, L.B ka paraqitur pranë AKSHI-t raport mjekësor i cili përfundonte më datë 27.03.2017 dhe në ditën në vijim L.B, nuk ka njoftuar punëdhënësin mbi gjendjen e shëndetit të saj, por në datë 03.04.2017 ka dorëzuar raportin për paaftësi të përkohshme në punë⁴, për periudhën prej datës 28.03.2017 deri më datë 12.04.2017.

Në lidhje për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se AKSHI në datë 28.03.2017 ka qenë pothuajse i gatshëm që të lëshonte urdhër revokimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me L.B për shkak të mosnjoftimit dhe nuk ka qenë i gatshëm që të revokonte këtë urdhër pas datës 03.04.2017 pasi është vënë në dijeni të ekzistencës së raportit mjekësor të L.B.

AKSHI në cilësinë e punëdhënësit ka patur mundësinë që në datë 28.03.2017 e në vijim në zbatim të Nenin 10.3 të Kontratës Individuale të Punës⁵ të jepte masë disiplinore për L.B për mungesën e lajmërimit për mungesë në punë dhe jo të ndërmernte veprimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pasi në cilësinë e punëdhënësit në vazhdimësi që prej datës 14.11.2016, ka qenë në dijeni të gjendjes shëndetësore të L.B dhe të përfitimit nga ana e saj të raporteve mjekësore të vlefshme.

Komisioneri ka bindjen se fakti që AKSHI nuk ka pritur që Vendimi Nr. 80-2017-930, datë 08.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të marrë formë të prerë, por e ka ekzekutuar menjëherë, sapo ka gjetur një mundësi për mosnjoftim të mungesës në punë të L.B, tregon tendencën e AKSHI-t për të ndërprerë marrëdhëniet e punës me subjektin ankues në kohë të papërshtatshme, pavarësisht se AKSHI nuk ka argumentuar se mungesa jo e vazhdueshme në punë e L.B në pozicionin e specialistes ka sjellë mosrealizimin e objektivave të punës të sektorit ku ishte e punësuar L.B.

Komisioneri vlerëson se, mungesat për shkak të gjendjes shëndetësore të ankuses, janë bërë shkak për AKSHI-n që të ndërprerë veprimin e revokimit të urdhrit pa pritur që vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë, pasi ka qenë vetë AKSHI që në datë 15.03.2017 ka ankimuar vendimin e gjykatës.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

⁴ Raport për paaftësi të përkohshme në punë, për 15 ditë paaftësie që fillon me datë 28.03.2017 deri më 12.04.2017, lëshuar me datë 31.03.2017 nga Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.3, protokolluar nga AKSHI nr.1016, datë 03.04.2017.

⁵ 10.3 “Mungesa e lajmërimit të punëdhënësit nga punëmarrësi lidhur me mungesën e tij në punë për shkak të sëmundjes apo çfarëdo shkakut tjetër ligjor, mund të përbëjë, sipas gjykimit të punëdhënësit, shkak për dhënien e masës disiplinore”.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7/1⁶, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se L.B, është ekspozuar ndaj një trajtimi të paforshtëm dhe diskriminues, nga ana e AKSHI-t, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me gjendjen shëndetësore të ankuseses.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 3/2 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Lidhur me pretendimi e ngritur nga L.B, se nga ana e AKSHI-t, nuk i janë dërguar pranë ISSH-s raportet mjekësore për datat 17.12.2016 deri 01.01.2017 dhe 27.01.2017 deri 31.01.2017 si dhe është bërë llogaritja jo e saktë e pagës pranë ISSH-s, nga ana e AKSHI-t, Komisioneri gjykon se me veprimet⁷ e kryera nga AKSHI në drejtim të përlllogaritjes së saktë dhe rregullimit të masës së pagesës së raportit mjekësor u arrit qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të shpërblimit të plotë të raportit për aftësi të përkohshme në punë për punonjësen L.B.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12 pika 1/c, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) dhe c), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasës L.B, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për shkak të gjendjes shëndetësore.

⁶ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

⁷ Referuar shkresës Urdhër Shpenzimi nr.215, datë 26.05.2017 dhe shkresës, Kërkesë për sistemim nr 1511, datë 11.05.2017 drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Në referim të pikës 1, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuuese, të bëjë rikthimin e L.B në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: gjendja shendetesore)
(fusha: punesim)